



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E SHTIMES

MUNICIPALITY OF SHTIME/ OPSTINA STIMLJE

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

/KANCELARIJA PRESELDNIKA OPSTINE/MAYOR'S OFFICE


ZYRA PËR INFORMIM/ INFORMATION OFFICE/ KANCELARIJA ZA
INFORMISANJE

Data/Datum/Date:	22. 1. 2024
Nr./Br./No	02 - 22
Për/Za/To:	Kuvendin e Komunës së Shtimes
Përmes/Preko/Through:	Qemajl Aliu, kryetari i komunës së Shtimes
Nga/Od/From:	Vlora Hyseni, zyrtare për Informim
Lënda/Predmet/Subject:	Draft-Plani i Veprimit për Transparency Komunale 2024-2028

Transparenca dhe llogaridhënia janë elementet thelbësore të qeverisjes së mirë në nivelin lokal, andaj rruga drejt informimit publik efikas duhet të jetë baza e qeverisjes së mirë, ndërkaq, komunikimi efektiv me qytetarët dhe pjesëmarrja e tyre në zhvillimin dhe zbatimin e politikave të komunës është aspekti kyç që siguron vendimmarrje me bazë të gjërë. Prandaj, kërkojmë nga Komiteti për Politikë dhe Financa, përaktësisht Kuvendi i Komunës së Shtimes që të nxjerrin në diskutim publik Draft-Planin e Veprimit për Transparency Komunale 2024-2028



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SHTIMES
MUNICIPALITY OF SHTIME/ OPSTINA STIMLJE
ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS
/KANCELARIJA PRESEDKA OPSTINE/MAYOR'S OFFICE



ZYRA PËR INFORMIM / INFORMATION OFFICE / KANCELARIJA ZA INFORMISANJE

DRAFT-PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENCE KOMUNALE

2024-2028

Shtime, 2024

Deklarata e transparencës

Kjo deklaratë ka për qëllim ofrimin e një pikëpamje gjithëpërfshirëse që pasqyron qartazi politikat, procedurat dhe masat tonë operative përkitazi me transparencën, gjithëpërfshirjen, kulturën organizative dhe llogaridhënien. Deklarata mbështetet në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Strategjinë Vetëqeverisje Lokale dhe aktet tjera komunale rregullative.

Plani i Veprimit për Transparencë synon të kontribuojë në ndërtimin e një administratë komunale llogaridhënëse dhe transparente, të hapur për qytetarët dhe shoqerinë civile në të gjitha proceset vendimmarrëse. Përmes Planit, do të promovohet koncepti i demokracisë së drejtpërdrejtë lokale, në mënyrë që politikbërja të bazohet në argumente, fakte dhe të dhëna reale. Plani është dokument strategjik komunal, i hartuar në pajtim me orientimet e përcaktuara nga Strategjia për Vetëqeverisje Lokale dhe aktet juridike përcjellëse të nivelit qendror që promovojnë qeverisjen transparente.

Llogaridhënia dhe transparenca janë parime që përtej informimit, synojnë mekanizma të përfshirjes së qytetarëve në procesin e politikbërjes dhe vendimmarrjes komunale. Për këtë arsy, zotohem që Komuna e Shtimes me gjithë sinqeritetin dhe përkushtimin do të rris gatishmërinë, për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive të gjitha kërkesave të qytetarëve për të qenë të angazhuar aktivisht në planifikimin dhe zhvillimin e politikave, për të siguruar që efektet e zbatimit të tyre të jatin rezultatet e dëshiruara dhe afektojnë direkt interesin e përgjithshëm të qytetarëve.

Me Plan të Transparencës, ne do të zbatojmë në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse standardet, parimet, objektivat, metodat dhe mjetet efektive për rritjen e llogaridhënieve, inkurajimin e qytetarëve për t'u bërë pjesë e qeverisjes, si dhe të ndikojmë tek punonjësit për të promovuar sjellje të mirë dhe të përgjegjshme.

Ne vlerësojmë se planifikimi i bazuar në informacion është metoda më e mirë e ndërtimit të qëndrueshëm të vizionit zhvillimor. Në funksion të kësaj, shërbimet cilësore komunale dhe administrimi i kërkesave të qytetarëve varet drejtpërdrejtë nga mënyra e shpërndarjes së informatave, sistemet e aplikuara të informacionit, teknikat e konsultimit dhe veprime të tjera përcjellëse të organeve të administratës.

Prandaj, jemi të përkushtuar që jo vetëm të zbatojmë masat e ndërlidhura me informim, por të bëjmë përpjekje për të siguruar praninë e vazhdueshme të qytetarëve dhe grupeve të interesit, me theks të veçantë organizatave të shoqërisë civile, duke përvjuar konceptin qytetarisë aktive dhe ndërtimit të qeverisjes së opinionit publik.

Besojmë që ky Plan Veprimit për Transparencë do të jetë një ndihmesë në rritjen e efikasitetit të shërbimeve, në krijimin e një ambienti më transparent të punës në administratë, rriten e besimit të qytetarëve ndaj të zgjedhurve të tyre publik, gatishmërisë dhe përkushtimit më të madh, si dhe përpjekjeve për të fuqizuar e përmirësuar sistemin e menaxhimit brenda komunal.

Kryetari i Komunës,

Janar, 2024

Qemajl Aliu

Hyrje

Transparenca dhe llogaridhënia janë elementet thelbësore të qeverisjes së mirë në nivelin lokal. Rruga drejt informimit publik efikas duhet të jetë baza e qeverisjes së mirë, ndërkaq, komunikimi efektiv me qytetarët dhe pjesëmarrja e tyre në zhvillimin dhe zbatimin e politikave të komunës është aspekti kyç që siguron vendimmarje me bazë të gjerë. Fryma e institucioneve komunale duhet të adoptoj modelet më të avancuara të qeverisjes transparente brenda kornizës ligjore në fuqi.

Transparenca komunale është njëra nga segmentet e qeverisjes e cila monitorohet në vazhdimësi nga qeveria qendrore, por edhe nga akterë të tjerë ndërkombëtar, Komisioni Evropian, organizatat ndërkombëtare, si dhe organizatat joqeveritare. Marrë parasysh nivelin e përgjegjësive dhe shkallën e decentralizimit të pushtetit lokal në Kosovë, Kushtetuta dhe legjislacioni kanë paraparë të drejtën e autoriteteve qendrore për të ofruar mbështetje dhe mbikëqyrje në fazë të caktuara të procesit të avancimit të transparencës dhe zhvillimit të politikave për përfshirjen e qytetarëve në vendimmarje lokale.

Komunat si njësi themelore të vetëqeverisjes lokale janë të obliguara t'i krijojnë mekanizmat e përshtatshëm të informimit publik. Tani, struktura e ueb-faqeve zyrtare të komunave është unike. Përmes tyre është krijuar mundësia për qasje në të gjitha dokumentet me rëndësi publike. Përveç karakterit informues, ato mundësojnë edhe procese administrative dhe linja me ndërsaqe të tjera të cilat shërbejnë për procesin e konsultimit publik. Ndërlidhja e tyre me sistemin e intranetit në komunë, mundëson që qytetarët të parashtrojnë online të gjitha kërkesat e tyre ndaj drejtorive përkatëse në Komunë.

Fusha e transparencës komunale ka një strukturë të mirëorganizuar të rregullave juridike ligjore dhe nënligjore. Plani i veprimit për transparencë synon t'i grupoj përgjegjësitë kryesore të komunave bazuar në këtë rregullativë juridike, për të shërbyer si dokument kornizë në një periudhë afatgjatë.

PLANI I VEPRIMIT PËR TRANSPARENÇË

Plani i Veprimit për Transparencë komunale ka për qëllim t'i ofrojë publikut qasje të lehtë në monitorimin dhe zbatimin e politikave nga organet e Komunës, duke përfshirë informim të shpejtë, të dhëna të qasshme, publikim të të gjitha akteve normative dhe dokumenteve me interes publik, si dhe rritje të mundësive të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarre.

Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, përkatësisht neni 42, pika 1, 2 dhe 3, përcakton obligimin që Komunat të hartojnë planin katër (4) vjeçar të veprimit për transparencë. Ky plan, kërkohet të përfshijë veprime që promovojnë: Mbledhjet e Kuwendit të Komunës, komitetet e takimet publike, takimet konsultative për projekt-akte, transparencën në planifikimin dhe shfrytëzimin e buxhetit të Komunës, qasje të shpejtë në shërbime, procedurat transparente të prokurimit, procedurat të punësimit, përditësimin e aktiviteteve ditore në faqe zyrtare, përfshirjen aktive të qytetarëve në vendimmarjen etj.

Plani i Veprimit për Transparencë mundëson:

- Ndërlidhjen e planifikimit me sistemet e informacionit në mënyrë që supozimet e organeve të administratës gjatë zhvillimit të politikave të vërtetohen dhe legitimohen;

- Përfshirjen e qytetarëve dhe shoqërisë civile në mënyrë aktive dhe të vazhdueshme;
- Rezultatet e punës së komunave të jenë të matshme, cilësore dhe në funksion të interesave të përgjithme të qytetarëve.

Plani i Veprimit për Transparencë në mënyrë specifike do të kontribuojë që:

- Komuna të identifikoj me kohë prioritetet për të cilat kërkohet informimi, si dhe përfshirja e qytetarëve apo grupeve të interesit;
- Të identifikoj metodat, mjetet dhe teknikat për konsultimin e qytetarëve dhe përfshirjen e tyre;
- T'i evitoj praktikat e zhvillimit të dokumenteve pa informacion të qartë dhe me kosto të papërballueshme;
- Krijimin e një mjedisi të brendshëm transparent dhe llogaridhënës, duke inkurajuar bashkëpërgjegjësi të të gjithë stafit në procesin e zhvillimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave;
- Mbajtjen e një sistemi koherent me të gjitha palët e interesit për të siguruar pajtueshmëri me kërkесat dhe standarde ligjore;
- Ndikimin në sjelljet e punonjësve komunal në mënyrë që veprimet e ndërmarra të demonstrojnë ligjshmëri dhe integritet.

Zbatimi i Planit të Veprimit për Transparencë do të monitorohet në vazhdimësi me mekanizma përkatës dhe do të rishikohet periodikisht në përputhje me aktivitetet e Komunës. Plani do të përmbedh në mënyrë të qartë transparencën e organeve komunale, publikimin e akteve nënligjore, rregulloret komunale, dokumentet strategjike, vendimet e kryetarit, njoftimet për aktivitetet e Kuvendit Komunal, takimet publike, transparencës buxhetore, prokurimin publik, zbatimin e standardeve të konsultimit, qasjen në dokumentet publike, etj.

Transparenca si parim i qeverisjes së mirë

Në një sistem demokratik funksional, informimi dhe përfshirja duhet të jenë segment vital i administrimit publik. Transparenca është komponentë kryesore e qeverisjes demokratike, e cila kërkon një hallkë të gjerë të veprimeve institucionale, si në procesin e hartimit të politikave ashtu edhe në fazën e zbatimit dhe raportimit. Rëndësia e transparencës ndikon në aspekte të shumta duke përfshirë qëndrueshmërinë ekonomike, financiare, qeverisjen e mirë, si dhe në sistemin e përgjithshëm të administratës shtetërore. Parimi i publicitetit dhe transparencës supozojnë se çdo kush ka të drejtë të dijë arsyet e nxjerjes së një vendimi të caktuar apo veprimi të administratës. Përmes këtij parimi mundësohet hapja e administratës para shoqërisë, informimi për punën e saj mund të bëhet në mënyrë të ndryshme dhe në vëllim të ndryshëm, parim që mund të kufizohet vetëm në rastet e caktuara në legjislacionin e secilit vend. Të qenurit i hapur dhe transparent janë gjithashtu instrumente të nevojshme për shtetin e së drejtës, barazinë para ligjit, dhe përgjegjshmërinë. Si rregull i përgjithshëm, sjellja e administratës publike duhet të jetë transparente dhe e hapur, megjithëse të dhënat personale nuk duhet t'i lejohen palëve të treta.

Transparenca është një nga çështjet më me peshë në procesin e demokratizimit të shteteve dhe qeverisjes së mirë. Këtë e mundësojnë mekanizmat dhe iniciativat e qeverisjes së hapur, të cilat bëjnë që përfitimet e transparencës të jenë në shumë aspekte, përfshirë: Qeverisjen më të mirë dhe

më efektive. Transparency përfshin rregullat mbi të drejtat e krijimit, ruajtjes, qasjes dhe përpunimit të informacionit, të cilat mund të shfrytëzohen gjatë proceseve të vendimmarres, por edhe për nevoja të informimit të përgjithshëm. Për më tepër, në kuptim më të gjerë transparency nuk është vetëm informim, por përfshinë një varg procesesh dhe veprimet për bazuara në: Informacion, komunikim, pjesëmarrje, angazhim, ndërtim të konsensusit për zgjidhjen e problemeve, raportim dhe llogaridhënie.

Korniza ligjore për transparencë

Në pajtueshmëri me Kushtetutën e Kosovës janë miratuar një numër i madh i ligjeve dhe akteve nënligjore, që rregullojnë fushën e transparencës. Ligji për Vetëqeverisje Lokale është aprovuar në vitin 2008 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe bën pjesë në grupin e ligjeve me karakter vital për shtetin. Përbajtja e këtij ligji reflekton parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisje Lokale, duke paraparë mekanizma të veçantë të informimit, pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të të drejtave të qytetarëve, e në veçanti të drejtave të komuniteteve joshumicë. Me këtë ligj është përcaktuar që kuvendi i komunës të miratojë rregulloren komunale që promovon transparency të organeve legislative, ekzekutive dhe administrative të komunës, duke e rritur pjesëmarrjen e opinionit në marrjen e vendimeve në nivel lokal dhe duke lehtesuar qasjen publike në dokumentet zyrtare të komunës. Përveç kësaj, me anë të një numri të konsiderueshëm të akteve nënligjore janë definuar edhe procedurat e zbatimit të instituteve të shumta juridike për transparencë, janë përcaktuar zyrtarët përgjegjës, format dhe teknikat për transparencë, si dhe afatet procedurale. Në përgjithësi, kuadri juridik normon obligime për organet e administratës shtetërore në fushën e transparencës, ndërsa në veçanti për organet e pushtetit, përmes akteve si në vijim:

- Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale;
 - Ligji Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike;
 - Ligji Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
 - Ligji Nr.03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë;
 - Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
-
- ❖ Rregullore Nr.02/2012/MF për Tarifat në Qasje në Dokumente Publike;
 - ❖ Rregullore (QRK) Nr.27/2018 për Shërbimin e Komunikimit Qeveritar me Publikun;
 - ❖ Rregullore (MAPL) Nr.0/2021 për Proceduren e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës.
-
- ✓ Udhëzim Administrativ (MAP) Nr.01/2015 për ueb-faqet e Institucioneve Publike;
 - ✓ Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komitetave Konsultative në Komuna;
 - ✓ Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna
 - ✓ Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.01/2021 për Funksionimin e Qendrave të Shërbimeve të Qytetarëve në Komunë;

Aktet komunale:

- Statuti i Komunës;

- Rregullore Komunale për Transparency;
- Strategjia për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun 2023-2025;
- Akte të tjera ligjore dhe nënligjore që ndërlidhen me fushën e transparencës.

Qasja strategjike për fuqizimin e transparencës

Në nivel qendror janë zhvilluar një numër strategjish të cilat parashohin objektiva me synim reformën e administratës shtetërore. Ndërsa strategjitet kryesore në fushën e qeverisjes së mirë, transparencës, llogaridhënieve dhe integritetit në institucionet e administratës janë:

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021;
- Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026;
- Strategjia për Rregullim më të mirë 2017-2021;
- Strategjia për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave 2017-2021;
- Strategjia për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2019-2023;
- Agjenda për Reforma Evropiane;
- Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit (PKMSA);
- Strategjitet e tjera sektoriale.

Dokument specifik me ndikim në transparencën komunale është Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026. Kjo strategji ka 5 objektiva kryesore përmes së cilave përcaktohen caqet afatmesme dhe afatgjata të zhvillimit të pushtetit lokal në Kosovë. Në objektin e tretë të saj, strategja parasheh *forcimin e partneriteteve ndërmjet pushtetit lokal, shoqërisë civile dhe bizneseve për të krijuar një qytetari aktive, gjithëpërfshirëse dhe kohezive*. Bazuar në problemet e identifikuara, në planin e veprimit të kësaj strategjie parashihen aktivitetet konkrete të masave, që përfshijnë zhvillimin e politikave efektive për të nxitur pjesëmarrjen e qytetarëve, respektivisht:

- Politikat lokale për nxitjen e aktivizimit qytetar;
- Politikat për nxitjen e punës vullnetare të studentëve dhe nxënësve;
- Politikat për funksionalizimin e qendrave rimore nëpër fshatra;
- Politikat për funksionalizimin e këshillave të fshatrave;
- Politikat për përfshirjen dhe angazhimin e pensionistëve në jetën publike;
- Politikat për angazhimin e personave me aftësi të kufizuara;
- Politikat për nxitjen e pjesëmarrjes së grave si dhe kategorive sociale të pambrojtura;
- Politikat lokale për krijimin e rrjetave sociale, ekonomike, rimore, sportive dhe kulturore. 1

Qeveria e Republikës së Kosovës: "Strategjia për Vetëqeverisje Lokale", Prishtinë, 2016, fq. 32

Strategjia parasheh po ashtu masa konkrete në krijimin e platformave që fuqizojnë transparencën, e në veçanti përmes qeverisjes elektronike. Qeveria elektronike sigurisht që lehtëson komunikimin në mes grupeve të interesit me autoritetet publike, derisa ajo forcon administratën përmes: Kursimit të kohës në ofrimin e shërbimeve, uljes së kostos operative, rritjes së efikasitetit, ruajtjes

së memories institucionale dhe rrıtjes së llogaridhënieve. Edhe strategji të tjera në nivel vendi ofrojnë qasje shumëdimensionale për ndërhyrje në politikat e transparencës. Një numër objektivash që synojnë krijimin e sistemit gjithëpërfshirëse dhe të menduar mirë në përgatitjen e politikave, janë paraparë në Strategjinë për Rregullim më të Mirë 2017-2021. Rekomandimet kyesore të dhëna nga kjo strategji theksojnë nevojën për:

- Hartimin e rregulloreve të bazuara në dëshmi, analiza dhe konsultime;
- Përmirësimin e mëtejshëm të komunikimit gjatë procesit të zhvillimit të politikave dhe gjatë fazës së zbatimit të tyre;
- Miratimin e rregulloreve dhe politikave nga qeveria, ashtu që komunikimi efektiv të sigurojë që grupet e synuara dhe palët e interesit njoftohen për të drejtat e tyre, mundësitë dhe detyrimet;
- Krijimin e një planifikimi të komunikimit përmes zhvillimit të planeve të komunikimit për priorititet e politikave, pasi që mbetet një sfidë e vazhdueshme;
- Krijimi i platformës online për konsultimet publike (objektiv i veçantë), si dhe
- Jetësimin e rregullave standard të konsultimit publik.

Krahas kësaj, Strategjia për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave në Kosovë 2017-2021, shtron nevojën për:

- Ndërlidhjen e dokumenteve sektoriale strategjike me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim;
- Ndërlidhjen e politikave me Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së;
- Zbatimin e strategjive sektoriale;
- Përmirësimin e koordinimit gjatë hartimit të politikave me të gjithë akterët;
- Rregullimin e afateve kohore gjatë konsultimeve ndërministrore dhe publike, për shkak se shpesh ato janë të shkurtra dhe nuk lejojnë ofrimin e një kontributi efektiv nga shoqëria civile.
- Intervenimet në reformat e planifikuara duke përfshirë konsultimin me palët e brendshme dhe të jashtme të interesit.

Komisioni Evropian ndër vite përmes raporteve të progresit ka identifikuar mangësi në fushën e transparencës duke renditur problemet kryesore, por në disa raste edhe të arritura. Referuar në të gjeturat e raportit të KE-së për vedin në vitin 2018, dobësitë vërehen në:

- Miratimin e projektligjeve nga Kuvendi i Kosovës pa një konsultim me grupet e synuara për shkak të procedurave të përshtypuara;
- Shkallë e dobët e kalimit të dokumenteve në diskutim publik (vetëm 21% të dokumenteve i janë nënshtruar konsultimit publik);
- Shkallë e ulët reagimit të shoqërisë civile dhe përfshirjes së publikut në vendim-marrje;
- Progres është evidentuar në hyrjen në fuqi të dy rregulloreve: Rregullores për Standardet e Konsultimit dhe Rregullores për Financimin e OJQ-ve.

Andaj, masat e tilla të ndërhyrjes janë të rëndësishme, për faktin se përmirësojnë komunikimin me qytetarë, krijojnë hapësirë për politik-bërje të qëndrueshme, zbatim efikas të tyre, si dhe plotësojnë obligimet e Kosovës në raport me kriteret e kërkua nga Bashkimi Evropian.

Mekanizmat ligjorë për pjesëmarrje dhe zbatim të parimit të transparencës

Qeverisja lokale në Kosovë promovon fuqishëm parimet e transparencës, llogaridhënieve dhe përfshirjet së qytetarëve në vendimmarje. Mënyra e parë dhe më e thjeshtë në të cilën transparenca mund të ndihmojë në ofrimin e pa-anësisë është duke lejuar publikun të luajë një rol të rëndësishëm në garantimin që rregullat të zbatohen në mënyrë të drejtë dhe korrekte. Qytetarët nuk mund të jenë askund më afër me shtetin sesa përmes organeve të pushtetit lokal. Komuna është adresa më e afërt për të kërkuar që shërbimet dhe resurset të shpërndahen në mënyrë të drejtë, të barabartë dhe në pajtim me nevojat sistematike të tyre.

Numri më i madh i taksave dhe tatimeve që mbledhen nga shteti, u shpërndahen komunave për ushtrimin e kompetencave ligjore. Taksat për të cilat qytetarët paguajnë në baza periodike janë burime vetanake të komunave, të cilat shpenzohen për shërbimet e ofruara. Planifikimi i shpenzimit të tyre bëhet me anë të buxhetit komunal, që është dokument kryesor vjetor që mbledh të gjitha projektet investive me interes publik. Gjatë përgatitjes së buxhetit, komunat ligjërisht obligohen të mbajnë konsultime me qytetarë, bizneset, grupet e interesit dhe shoqërinë civile. Prandaj, qeverisja e mirë komunale do të zinte vend vetëm nëse planifikimi i mjeteve buxhetore, politikave të tjera, shpenzimet e tyre dhe mënyra e shpërndarjes së investimeve publike do të mbështetej në opinionin e qytetarëve, përmes formave të shumta të përfshirjes direkte të tyre.

Në mënyrë që transparenca të jetë pjesë përbërëse e politik-bërjes në nivel lokal, Ligji për Vetëqeverisje Lokale ka përcaktuar një numër të shumtë të instrumenteve juridike për pjesëmarrje të qytetarëve në jetën publike ku bëjnë pjesë:

- Takimet publike gjithëpërfshirëse me qytetarë;
- Konsultimet për projekte dhe dokumente të politikave;
- Informimi dhe konsultimi përmes e-qeverisjes;
- Bashkëpunimi me shoqërinë civile;
- E drejta për qasje në dokumentet publike;
- Komitetet konsultative;
- Iniciativat qytetare, peticionet dhe referendumet lokale.

Të gjitha këto forma kanë bazën e tyre juridike, procedurale, mjetet dhe format e zbatimit të tyre. Efekti i tyre në përmirësimin e qeverisjes lokale vërehet përmes rritjes së transparencës, krijimit të qytetarisë aktive dhe forcimit të dialogut social. Edhe pse të shumta, aplikimi i tyre ndryshon nga njëra komunë në tjetrën, për çka tregojnë statistikat e shumta të dala nga raportet e monitorimit të institucioneve të ndryshme publike dhe jopublike. Gjithashtu, jo të gjitha janë të zbatueshme për shkaqe juridike, por edhe praktike.

Objektivat e Planit të Veprimit për Transparencë

Objktivi kryesor i Planit të Veprimit për Transparencë Komunale është “të siguroj qeverisje të hapur për qytetarë, gjithëpërfshirje në procesin e planifikimit dhe zhvillimit të politikave, si dhe qeverisje transparente e llogaridhënëse”.

Objektivat specifike janë:

- Sigurimi i një kornize të qartë të planifikimit të organizuar, ku përcaktohen rolet e të gjithë pjesëmarrësve përgjegjës për transparencë komunale;
- Fuqizimi i mekanizmave lokal të demokracisë direkte, për të krijuar një publik të interesuar për çështje publike;
- Avancimi i mekanizmave të informimit në mënyrë që qytetarët të dëgjojnë dhe të inkurajohen për të qenë aktiv në proceset vendim-marrëse;
- Krijimi i një sistemi efektiv qeverisës, në të cilin parim kryesor i draftimit të politikave është baza e informacionit;
- Ndërtimi i partneritetit të mirëfilltë me shoqërinë civile, në të gjitha fazat e menaxhimit të organeve komunale.

Fazat e zhvillimit të Planit të Veprimit për Transparencë Komunale

Zhvillimi i Planit të Veprimit për Transparencë përbëhet prej disa fazave si në vijim:

1) **Faza paraprake** - Kryetari i komunës themelon grupin punues. Përbërja e grupit punues duhet të jetë shumësektorial dhe të udhëhiqet nga Zyra për Komunikim me Publikun në bashkëpunim me Zyrën Ligjore të komunës. Procedurat e hartimit zhvillohen në pajtim me rregullat në fuqi për procedurat e hartimit të akteve komunale.

2) **Faza e vlerësimit të prioriteteve** – Gjatë kësaj faze, kryesuesi së bashku me grupin punues analizojnë dokumentacionet e mbledhura (legislacionin dhe aktet nënligjore të zbatueshme në punën e administratës së komunës, dokumentet strategjike të komunës mbi bazën e të cilave priten të zhvillohen aktet juridike të komunës, planet komunale, dokumentet e tjera të politikave për të cilat duhet të zhvillohen konsultime publike dhe të sigurohet prania e qytetarëve. Mbi bazën e analizës së gjendjes aktuale dhe planeve afatshkurtëra, afatmesme, dhe afatgjate, duhet të përcaktohen prioritetet dhe të bëhet renditja e veprimeve për secilin aktivitet.

3) **Faza e përcaktimit të aktiviteteve dhe propozimit të masave** – Kjo fazë përfshin kategorizimin e prioriteteve sipas periudhave të zhvillimit, renditjen e aktiviteteve, metodave dhe mjeteve të veprimit, afatet kohore, organet/zyrtarët përgjegjës, koston financiare.

4) **Faza e monitorimit dhe raportimit të planit të veprimit për transparencë** – Përfshin monitorimin, regjistrimin dhe raportimin e rregullt të aktiviteteve që zhvillohen sipas Planit të Veprimit për Transparencë. Raportimi mundëson që informacionet e mbledhura të përdoren në marrjen e vendimeve që përmirësojnë zbatimin e objektivave të Planit të Transparencës. Kryesuesi i grupit punues merr pjesë në grupin punues për hartimin e planit vjetor të punës së komunës.

Metodologjia e vlerësimit dhe përcaktimit të aktiviteteve të transparencës

Vlerësimi i aktiviteteve të transparencës do të thotë renditja e veprimeve në Plan sipas prioriteteve, duke mundësuar që komuna të jetë e hapur dhe bashkëpunuese me qytetarë në të tri fazat kyçë të menaxhimit:

- a) Planifikim;
- b) Zbatim;
- c) Raportim.

Prioritetet përcaktohen duke marrë për bazë rëndësinë e proceseve, përkatësisht: Natyrës së veprimtarisë që do të ndërmerr nga organi përkatës i komunës, llojeve të dokumenteve të politikave për të cilat kërkohet përfshirja e qytetarëve, fushëveprimit të akteve juridike të planifikuara për hartim, ndikimit të tyre ekonomik dhe social, peshës financiare të politikës së propozuar, periudhës kohore të veprimit, shtrirjes gjeografike etj.

Pas përcaktimit të aktiviteteve grupi punues cakton prioritetet dhe metodat e veprimit të cilat duhet të jenë pjesë përbërëse e planit të veprimit, të cilat janë të ndryshme varësisht se për cilën fazë të menaxhimit bëhet fjalë.

Monitorimi i zbatimit të Planit të Transparencës

Zbatimi i Planit të Veprimit për Transparencë do të monitorohet në vazhdimësi me mekanizma përkatës, do të rishikohet periodikisht dhe do të azhurnohet në përputhje me zhvillimet relevante normative, institucionale, procedurale dhe të personelit brenda mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm të Komunës.

Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit është i rëndësishëm për t'u siguruar se masat e parapara janë efektive dhe ndikojnë në cilësinë e politik-bërjes, si parakusht i ligjshmërisë së procesit vendim-marrës.

Gjithashtu monitorimi duhet të përcaktojë nëse masat e përdorura kanë prodhuar efektet e planifikuara, kanë sjellë vendim-marrje cilësore, efikase dhe efektive, me kosto reale dhe të përballueshme.

Raportimi i rregullt siguron se zbatimi i Planit bëhet në përputhje me orarin dhe se rezultatet e planifikuara janë arritur.

Me qëllim të sigurimit të zbatimit të Planit të Veprimit për Transparencë, krijohet mekanizmi për monitorimin dhe raportimin për këtij plani, si në vijim:

Grupi punues – Emërohet me vendim të kryetarit të komunës dhe është përgjegjës për:

- Hartimin e Planit të Veprimit për Transparencë Komunale;
- Grupi është njëherësh sigurues i zbatimit të planit dhe garanton që në baza periodike Plani Vjetor i Punës së Komunës të ndërlidhet me aktivitetet dhe masat e përcaktuara në Planin Vjetor të Veprimit për Transparencë;
- Kryesuesi i grupit Punues merr pjesë në grupin punues për hartimin e Planit Vjetor të Punës së Komunës.

- Propozon masa të nevojshme për zbatimin e plotë të masave të propozuara në Planin e Veprimit për Transparencë;
- Monitoron zbatimin e masave për përmirësimin e transparencës;
- Raporton tek kryetari për zbatimin e Planit të Veprimit për Transparencë.

Plani i Veprimit për Transparencë Komunale 2024-2028

Objektivat	Aktivitet	Treguesit e matjes	Afati kohor	Njësia/personi përgjegjës	Mënyra e njoftimit/zba timit	Dokumenet referuese	Kolonë raportimi
Transparencia e Kuvendit të Komunës së Shtimes							
Informimi i rregullt i qytarëve dhe grupeve të interesit për aktivitetet e Kuvendit të komunës dhe komiteve	Publikimi i njoftimeve, sigurimi i materialeve të nevojshme, hapësirës për pjesëmarrjen publike dhe përfaqësuesit e mediave të shkrura/elektroni ke në takimet e Kuvendit të Komunës dhe komiteve	1) Numri i njoftimeve të shpallura në gjuhët zyrtare përmblledhje të kuvendit në ueb faqe zyrtare të komunës; 2) Numri i njoftimeve të shpallura në gjuhët zyrtare përmblledhje të komiteteve në ueb faqe zyrtare të komunës	1) Njoftimi shtatë (7) ditë punë para mbledhjeve të rregullta kuvendit; 2) Njoftimi 3 ditë punë para mbledhjes së jashtëzakonshme; 3) Thirrja brenda ditës përmblledhje urgjente	Kryesuesi i Kuvendit të Komunës	Përmes uebfaqes zyrtare; Shpalljeve publike; Formave të tjera të informimit.	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.4/2023 për Administratë të Hapur në Komuna;	-Ligji Nr.03/L-040 për Vëtëqever isje Lokale; -Statuti i Komunës; Rregullori i komunale për transparençë

	Transmetimi në kohë reale i mbledhjeve të kuvendit të komunës	Numri i mbledhjeve të kuvendit të transmetuara drejt përdrejt	Në vazhdimësi	Sekretaria e Kuvendit; Zyrtari i IT-së; Zyra e Informimit.	Përmes ueb-faqes zyrtare; Rjeteve sociale; YouTube;	-Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqever isje Lokale;
				Mediave lokale.	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.4/2023	për Administratë të Hapur në Komuna;
					Statuti i Komunës	Rregullor e (MAPL) Nr.01/2017 për procedurë
Publikimi i akteve të kuvendit të komunës				1) Numri i akteve të aprovuara; 2) Numri i akteve të publikuara në gjuhët zyrtare	Kryesuesi i Kuvendit; Zyra për Informim;	Ueb-faqja e komunës; Gazeta Zyrtare e Kosovës
				Pas afatit 15 ditor të shqyrtimit të ligjshmërisë nga ministria përgjegjëse për qeverisje lokale	Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqever isje Lokale;	

			n e hartimit dhe publikimi n e akteve të komunës	
Publikimi i Planit të punës së kuvendit të komunës	Plani i publikuar në gjuhët zyrtare në ueb-faqen zyrtare të komunës	Fillimi i muajit Janar	Zyra për Informim	Ueb-faqja e komunës; Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.4/2023 për Administratë të Hapur në Komuna;
Ofrimi i qasjes së drejtësive rrejtë në informata dhe dokumente publike	Informatat dhe dokumentet zyrtare të publikuara në ueb-faqen e komunës	Në vazhdimësi	Zyra për Informim; Njësitë organizative; Sekretaria e Kuvendit	Ueb-faqja e komunës; Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.4/2023 për Administratë të Hapur në Komuna;
Publikimi i raporteve të punës së kuvendit të komunës	Raporti vjetor i publikuar në gjuhët zyrtare	Deri më 31 janar për vitin paraprak	Zyra për Informim;	Ueb-faqja e komunës; Udhëzimi Administrativ

		Sekretaria e Kuvendit	Platforma të tjera sociale.	(MAPL) Nr.4/2023 për Administratë të Hapur në Komuna;
Publikimi i profileve të anëtarëve të kuvendeve të komunave	Biografitë e anëtarëve të kuvendit dhe të dhënat kontaktuese të publikuara.	Me rastin e marjes së mandatit;	Zyra për Informim; Sekretaria e Kuvendit	Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.01/2015 për ueb-faqet e institucioneve publike
Publikimi i të dhënave përbëjen e komiteve të kuvendit dhe funksioneve të tyre	1) Të dhënët e përfaqësuesve në komitete të publikuara; 2) Vendimet për themelimin e komiteve të publikuara; 3) Përgjegjësitë e komiteve të përshkruara në ueb-faqe	Sipas kohës së themelimit dhe funksionalizimit;	Zyra për Informim; Sekretaria e Kuvendit	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.4/2023 për Administratë të Hapur në Komuna; Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.01/201

				5 për ueb-faqet e institucioneve publike
				Transparencia e Kryetarit të Komunës/Përfshirja e qytetarëve/Qasja në dokumentet publike/Informimi publik
Përfshirja e qytetarëve në politik-bërie	Publikimi i akteve të kryetarit të komunës	Lista e akteve të aprovuara e publikuar	Në vazhdimësi	Zyra për Informim; Zyra e kryetarit;
Përfshirja e hershme e publikut në procesin e planifikimit		Draft-Plani i ekzekutivit përvitin e ardhshëm kalendarik i publikuar përkonsultim me qytetarë	Deri në fund të muajit dhjetor	Zyra për Informim; Zyra e Kryetarit;
Publikimi i listës së pronave të planifikuara përdhënies në			Deri më 31 dhjetor të	Zyra për informim;
				Ueb-faqja e komunës; Ligji Nr.06/L-092 për

	dhënie në shfrytëzim përvitn e ardhshëm, pas miratimit në Kuvend të Komunës	shfrytëzim, e publikuar	vitit paraprak	Zyra e Kryetarit; Sekretaria e kuvendit;	Gazeta Zyrare e Kosovës	dhëniënë shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtsh me të komunës	Rregullorë (MAPL) Nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimi i akteve të komunës	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.4/2023 për Administratën e
--	---	-------------------------	----------------	--	-------------------------	--	--	---

	Mbajtja e së paku dy takimeve publike me qytetarë brenda vitiit	2 takime të mbajtura gjatë vitit	Takimi i parë në gjashëmujor in e pare të vitit; Takimi i dytë në gjashëmujor in e dytë të vitit	Zyra për Informim; Zyra e Kryetarit; Zyra për Informim; Zyra e Kryetarit;	Njofitimi përmes ueb-faqes së komunës; Shfrytëzimi i platformave online të komunikimit; Takime të drejtëpërdrejtë; Administratë të	Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqever isje Lokale; Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.4/2023 për Administratë të	Hapur në Komuna; Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqever isje Lokale; Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.4/2023 për Administratë të
	Numri i takimeve konsultative tjera në kuadër të lagjeve, vendbanimeve dhe lokacioneve tjera.			Njofitimi i shpallur 14 ditë para takimit në gjuhët zyrtare; Numri i takimeve për të cilat kërkesat dhe rekomandimet e dhëna nga publiku janë evidentuar dhe publikuar në ueb faqen zyrtare të	Zyra për Informim; Zyra e Kryetarit; Zyra për Informim; Zyra e Kryetarit;	Njofitimi përmes ueb-faqes së komunës; Shfrytëzimi i platformave online të komunikimit; Takime të drejtëpërdrejtë;	Ligji Nr.03/L-040 për Vetëqever isje Lokale; Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.4/2023 për Administratë të

	komunës, brenda 15 ditëve pas përfundimit të takimit.			atë të Hapur në Komuna;
Shqyrtimi i kërkesave/iniciati vave dhe peticioneve të qytetarëve	<p>1) Numri i kërkesave, iniciativave qytetare dhe peticioneve të parashtruara tek Kryetari;</p> <p>2) Numri i iniciativave,kërkes ave, iniciativave qytetare dhe peticioneve të shqyrtuara brenda 60 ditësh;</p> <p>3) Numri i njoftimeve të publikut brenda 15 ditësh për kërkesat, iniciativat qytetare dhe peticionet e parashtruara</p>	<p>Në vazhdimësi</p> <p>Kryetari i Komunës;</p> <p>Kuvendi i Komunës</p>	<p>Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.4/2023</p> <p>për Administrat atë të Hapur në Komuna;</p>	
Themelimi i komiteteve konsultative	Numri i kërkesave të parashtruara për themelim të komiteve;	Pas parashtrimit të kërkesës/ ose me rastin e përfundimit	Kuvendi i Komunës	<p>U.A. 01/2016</p> <p>për procedurë n e themelimi</p>

	konsultative të themeluara;	të mandatit të komitetit	t, organizim in dhe kompeten cat e komitetev e konsultati ve në komuna
Inkurajimi i qytetarëve për pjesëmarrje në diskutimet buxhetore	Mbaftja e takimeve me qytetarët për KAB	Numri i takimeve me qytetarët për 30 korrik	<p>Kryetari i Komunës</p> <p>Drejtoritë</p> <p>Para datës 30 korrik</p> <p>Njoftimi përmes ueb-faqes së komunes, apo shpaljeve të tjera;</p> <p>Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.4/2023 për Administrat atë të Hapur në Komuna;</p> <p>Takimet të drejtëpërdrejtë; Konsultimet me shkrim;</p> <p>Konsultimet elektronike; Platforma qeveritare për konsultime publike;</p> <p>Format tjera të përcaktuara në nenin 10 të U.A për</p>

				standardet minimale të konsultimit publik.
Publikimi i KAB- it	KAB i publikuar në ueb-faqen e komunës	Pas miratimin në Kuvendin Komunal	Zyra për informim;	Ueb-faqja e komunës
Mbajtja e konsultimeve me qytetarë për projektbuxhetin e komunës	Konsultimet publike për projektbuxhet, të mbajtura	Para datës 1 shtator	Zyra e Kryetarit Kryetari i Komunës/Drejt oritë	Njoftimi përmes ueb- faqes së komunës, apo shpalljeve të tjera; Takime të drejtëpërdrejta; Konsultimet me shkrim;

			në nenin 10 të U.A. për standardet minimale të konsultimit publik	Ueb-faqja e komunës	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.4/2023 për Administratën të Hapur në Komunë;	Ligji Nr.03/L-040 për Vëtëqeverisje Lokale;	Inkorporomi në rend dite; Diskutimi në kuvend	në nenin 10 të U.A. për standardet minimale të konsultimit publik
Publikimi i buxhetit vjetor	Plani buxhetor i publikuar në ueb-faqen e komunës	Pas miratimit në kuvendin e komunës	Zyra për Informim; Zyra e Kryetarit;	Kryetari i Komunës; Ekzekutivi; kuvendi i komunës	Kryetari i Komunës; Ekzekutivi; kuvendi i komunës	Kryetari i Komunës; Ekzekutivi	Inkorporomi në rend dite; Diskutimi në kuvend	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.4/2023 për Administratën të Hapur në Komunë;
Rritja e transparencës dhe llogaridhënieve së kryetarit/ekzekutivit	Diskutimi i raportit të kryetarit në kuvendin e komunës	Raportet e paraqitura për diskutim në kuvendin e komunës	Njëherë në gjashë muaj apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i komunës	Kryetari i Komunës; Ekzekutivi; kuvendi i komunës	Kryetari i Komunës; Ekzekutivi	Kryetari i Komunës; Ekzekutivi	Inkorporomi në rend dite; Diskutimi në kuvend; Publikimi në ueb-faqe	Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjës
	Dorëzimi i raporteve tremujore financiare në kuvendin e komunës dhe publikimi në ueb-faqen zyrtare	1) Raportet e paraqitura për diskutim në kuvendin e komunës; 2) Raportet e publikuara në ueb-faqe	1) Tremujori 4 para datës 31 Janar; 2) Tremujori 1 para datës 30 Prill;	1) Tremujori 4 para datës 31 Janar; 2) Tremujori 1 para datës 30 Prill; 3) Tremujori	1) Tremujori 4 para datës 31 Janar;	1) Tremujori 4 para datës 31 Janar;	Inkorporomi në rend dite; Diskutimi në kuvend; Publikimi në ueb-faqe	Ligji Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjës

2 para datës 31 Korrik; 4) Tremujori 3 para datës 31 Tetor	itë Ligji Nr.03/L- 040 për Vetëqever isje Lokale;	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.4/2023 për Administratë të Hapur në Komuna;	Ligji Nr.03/L- 048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjës itë;	Udhëzimi Administrativ
Publikimi i raportit përfundimtar financiar	Raporti i publikuar Jo më vonë se me 31 Mars të çdo viti kalendarik	Kryetari i Komunës; Ekzekutivi		

			(MAPL) Nr.4/2023 për Administratë të Hapur në Komuna;
Publikimi i listës së subjekteve përfituese nga kategoria e subvencioneve	Lista e përfituesve të subvencioneve, e publikuar; Drejtoria përkatëse	Zyra e Informimit miratimit të listës nga ana komisionit vlerësues	Ueb-faqja zyrtare e komunës; platformat e tjera sociale
Diskutimi i raportit të Zyres Kombëtare të Auditimit në Kuvendin e Komunës	Raporti i inkorporuar në rend të ditës dhe i diskutuar në KK	Pas publikimit nga ZKA	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.4/2023 për Administratë të Hapur në Komuna;
Sigurimi i transparencës në procedurat e prokurimit publik	Plani i prokurimit i publikuar në ueb-faqe	Pas miratimit dhe shpalljes së ligjet vjetor për Prokurim	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.4/2023 për

		ndarjet buxhetore			Administratëtë Hapur në Komuna;
Publikimi i Raportit vjetor të zbatimit të planit për prokurim publik	Raporti i prokurimit i publikuar	Jo më vonë se 31 janar, përvitin paraprak	Drejtoria e Prokurimit në bashkëpunim me Zyriën e Informimit	Ueb-faqja e komunës Ligji i Prokurimit Publik; Udhëzimit Administrativ (MAP), Nr. 01/2015 për ueb-faqet e Institucioneve Publike	Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik; Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.4/2023 për Administrat

				atë të Hapur në Komuna;
Publikimi i gjitha aktiviteteve të prokurimit në ueb-faqen e komunës	Numri i aktiviteteve të prokurimit të publikuara në	Në vazhdimësi	Drejtoria e Prokurimit bashkëpunim me Zyrtën e informimit	Ueb-faqja e komunës; E-prokurimi Ligji i Prokurimit Publik; Udhëzimit Administrativ (MAP), Nr. 01/2015 për ueb-faqet e Institucioneve Publike

				atë të Hapur në Komuna;
Ngrisia e cilësisë së dokumenteve të politikave dhe aktive të komunës përmes zbatimit të standardeve minimale të konsultimit publik	Krijimi i strukturave përgjegjëse komunale për koordinimin dhe zbatimin e standardeve minimale të konsultimit publik	Zyrtari përgjegjës për konsultim publik, i caktuar me vendim të kryetarit	Kryetari i Komunës	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.4/2023 për Administrat atë të Hapur në Komuna;
Përgatitja e planit të vëçantë për vitin vijues	Plani i vëçantë i hartuar	Muaji dhjetor për vitin vijues	Zyrtari përgjegjës për konsultim publik; Njësitë organizative të komunës	Inkorporomi i aktivitetve të planit vjetor të punës së komunës në planin e vëçantë për konsultime
Informimi me kohë për dokumentet, projektakta, mënyrat dhe format e konsultimit, vendin dhe afatet	1. Numri i akteve/dokumenteve për të cilat kërkohet konsultimi publik; 2) Numri i njoftimeve të shpallura për konsultime	Së paku tetë (8) ditë dhe maksimum katërbëdhje etë (14)	Zyrtari përgjegjës për koordinim me zyrtarin përgjegjës për hartim të projektapropozimit	Ueb-faqja e komunës; Rrjetë sociale; Media lokale etj.

	Hapur në Komuna;		
e konsultimit publik	<p>publike;</p> <p>3) Bashkëngjitja projektpropozimit, dokumentin konsultues që përmban afatet e konsultimit, memorandumet shpjeguese dhe adresën për pranimin e komenteve</p>	<p>Me rastin e themelimit të grupeve punuese</p> <p>Numri i grupeve punuese që përfshijnë qytetarët/shoqëritë civile</p>	<p>Njoftimi përmes uebfaqes/thirjeve e publike/Përfshirjes në aktet themeluese</p> <p>Kryetari i Komunës; Organizatorë propozues</p> <p>atë të Hapur në Komuna;</p>
Pjesëmarrja e publikut në grupet punuese	<p>Numri i grupeve punuese të themeluara;</p> <p>Numri i grupeve punuese që përfshijnë qytetarët/shoqëritë civile</p>	<p>Me rastin e themelimit të grupeve punuese</p> <p>Organizatorë propozues</p>	<p>Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.4/2023 për Administratoren; atë të Hapur në Komuna;</p>
Hapja e menusë/rubrikës të vecantë me të dhënat e procesit të konsultimit publik	<p>Menuja/Rubrika e krijuar në uebfaqe;</p> <p>Vëgëza/ikona e integruar në uebfaqe për Platformën e Qeverisë për konsultime publike.</p>	Zyra e Informimit	<p>Në koordinim me MAPL-në dhe Zyren për Qeverisje të Mirë</p> <p>Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.4/2023 për Administratoren; atë të Hapur në Komuna;</p>

	Mbledhja/shqyrtimi i komenteve/propozimeve gjatë procesit të konsultimit publik dhe përgatitja raportit për rezultatet e konsultimit publik	1. Numri i komenteve të parashtruara; 2) Raporti për rezultatet e konsultimit publik i hartuar dhe publikuar.	Së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë dhe jo më shumë se tridhjetë (30) ditë kalendarik përfundimt të afatit për paraqitjen e propozimeve dhe vërejtjeve me shkrim	Zyrtari përgjegjës për hartim të projektpozit mit në bashkëpunim me grupin punues dhe zyrtarin përgjegjës për konsultime publike	Publikimi në ueb-faqe i formularit standard për konsultimet publike;	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.4/2023 për Administratë të Hapur në Komuna;
	Garantimi i plotë i të drejave për qasje në dokumentet publike	Shqyrtimi i rregullt i kërkesave të parashtruara nga palët; 2) Numri i kërkesave të shqyrtuara përtë cilat palët kanë marrë përgjigje	1) Numri i kërkesave të parashtruara nga palët; 2) Numri i kërkesave të shqyrtuara përtë cilat palët kanë marrë përgjigje	(7) ditë nga dita e pranimit të kërkessës nga kërkuesi	Zyra për informim/Zyrtari i përgjegjës për qasje në dokumentet zyrtare;	Ligji Nr.06/L-081 për Qasje në Dokument e Publike

		Njësia përgjegjëse për ofrimin e qasjes		
Mbajtja e evidencës zyrtare, në formë të regjistrat ose ngjashëm, përkizazi me kërkesat, veprimet, procedurat dhe vendimet, lidhur me realizimin e të drejtave të personave fizik dhe juridik, në qasje në dokumente dhe informata zyrtare.	Përditësohet çdo tre (3) muaj	Zyra për informim/Zyrtari i përgjegjës për qasje në dokumentet zyrtare/	Ueb-faqja e komunës	Ligji Nr.06/L-081 për Qasje në Dokument e Publike
Hartimi dhe publikimi i raportit për qasje në dokumentet publike	1) Raporti vjetori i hartuar dhe dorëzuar në Agjencinë për informim dhe privatësi; 2) Raporti i publikuar në ueb-faqe	Jo më vonë se 31 janar	Zyrtari përgjegjës për qasje në dokumentet zyrtare	Ueb-faqja e komunës
Përbushja e kritereve të ueb-faqes	1) Numri i shërbimeve që ofron institucionin	Në vazhdimësi	Drejtoria e Administratës	Udhëzim Administrativ

zyrtare, lehtësimi i shërbimeve dhe informimi i rregullt për qytetarë	për publikun; 2) Numri i procedurave dhe kushteve të përfitimit të tyre dhe afati i detryueshëm për të marrë përgjigje për shërbimin e kërkuar të publikuara në gjuhët zyrtare; 3) Lista e hollësishme e shërbimeve që ofron institucion për publikun, si: licenca, leje, autorizime, cert ifikata, vërtetim apo shërbime publike të tjera, ku do të përfshihen, e publikuar në gjuhët zyrtare	Zyra për informim	Qendra për Shërbim të qytetarëve	(MAP) Nr.01/201 5 për ueb- faqt e institucion eve publike;
		Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.4/2023	Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.4/2023 për Administratë të Hapur në Komuna;	
	Ofrimi i shërbimeve elektronike nga Qendra	Informimi dhe ofrimi i shërbimeve të hapura on-line nga Qendra.	Në vazhdimësi	Drejtori i Administratës/ Qendra për Shërbim të Qytetarëve

		Administratëtë Hapur në Komuna;
		Udhëzim Administrativ (MAPL) Nr.01/2021 përfshirë Funksionimin e Qendrave të Shërbimeve të Qytetarëve në Komunë
Offimi i shërbimeve për qytetarët përmes E-kioskës.		